


**"VESHJET POPULLORE NË QARKUN E VLORËS DHE
PARAQITJA E TYRE NË FESTIVALIN FOLKLORIK
KOMBËTAR GJIROKASTËR 20015"**



DRTK VLORË
DREJTORIA RAJONALE E
TRASHËGIMISË KULTURORE VLORË

ZHVILLIMI I FESTIVALIT

- ❖ **Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastër 2015 u zhvillua nga 10-16 maj.**
- ❖ **Qarku i Vlorës është paraqitur me dinjitet jo vetëm në këtë takim por në të gjitha takimet e Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastër madje edhe është vlerësuar më çmime të ndryshme.**
- ❖ **Gjatë fazes së parë për përzgjedhjen e grupeve të ndryshme folklorike të cilat do të përbënin dhe grupin përfundimtar të Qarkut Vlorë ju kushtua rëndësi e veçantë dy elementëve, materialit folklorik të shprehur në këngë, valle apo rite dhe veshjes tradicionale**

Bartësit e folklorit sollën në skenën e festivalit I Armishmëri të Veshjeve si:

- ❖ **Veshjen me fustanell**
- ❖ **Veshja me poture**
- ❖ **Veshja me këmishë të gjatë dhe përparje**
- ❖ **Veshja tradicionale të Qytetit të Vlorës**
- ❖ **Veshjen tradicionale të grave çame.**

VESHJE ME POTURE

- ❖ Poturet kanë formën e pantollonave të gjëra e të gjata deri në gju. Ndryshe nga veshjet e tjera këto lloj pantollonash kanë mjaft ndikim (në formën e prerjes) nga e njëjta veshje e përdorur në vendet orientale.
- ❖ Në pjesën e poshtme të këmbëve (poshtë gjurit) visheshin kalce prej shajaku. Ndersa në pjesën e sipërme vishej këmisha me mëngë të gjata e shoqëruar me një jelek prej shajaku, i cili mbërthehej në pjesën anësore të gjoksit.
- ❖ Në stinë të ftohtë vishej dhe një xhamadan me mëngë që i vareshin në pjesën e pasme të trupit. Kjo veshje kishte edhe një pjesë tjetër që dallonte nga krahinat e tjera, është pikërisht qeleshja e lartë ose takija gjysmë sferike.
- ❖ Kjo veshje ka patur përhapje të kufizuar, kryesisht në Labëri, Mallakastër, Myzeqe etj. Poturet kanë zëvendësuar veshjen me fustanellë aty nga fundi i shek. XIX.

VESHJE ME POTURE



ZVENDËSIMI I KËPUCËVE ME OPINGA ME XHUFKË



VESHJE ME FUSTANELLË.

Edhe kjo veshje burrash këtë emërtim e merr nga një lloj fundi i bardhë, i bërë me pëlhurë pambuku dhe me shumë rrudha.


Nën këtë fund mbatheshin të mbathura të gjata, mbi të cilat nga nyja e këmbës e deri tek gjuri visheshin kallçi prej shajaku. Në disa raste këto zgjateshin deri në rrzë të kofshëve, prandaj dhe quhen kofshare. Në pjesën e sipërme vishej një këmishë e shkurtër me mëngë të gjëra, jeleku dhe mëngorja (në mënyrë të varura pas).

Në bel vinin një brez të gjërë leshi, mbi të dhe një tjetër prej lëkure të zbukuruar mbi të cilin futeshin e vareshin armët e brezit. Në stinën e ftohtë pjesë e kësaj veshje ishte edhe flokata e leshit. Ndonse në kokë vihej një festë e bardhë me një thumb në mes.

Deri në fillim të shek. XX kjo veshje është mbajtur në të gjitha trevat shqiptare, që nga Kosova e deri në çamëri. Më pas ajo u kufizua vetëm në fshatrat e Shqipërisë së Jugut.

VESSHJE ME FUSTANELL





VEHJE ME FUSTANELL



MODELE TË NDRYSHME TË JELEKËVE



Drashovic ,Dukat, Brat

Grupi Vlleh i Selenicës



VESHJE ME KËMISHE TË GJATË DHE PËRPARJE

- ❖ Pjesë kryesore e kësaj veshje është këmisha e gjatë, me mëngë të gjata, të gjera ose të ngushta.
- ❖ Në mes ajo shtrëngohej nga nje brez lesi me ngjyra të ndryshme dhe shoqërohej në pjesën e përparme nga një përparse e leshte ose e pambuktë me madhësi e zbukurime që ndryshonin nga njëra krahinë në tjetrën.
- ❖ Në stinën e verës, në pjesën e sipërme gruaja e veshur me këtë këmishë mbante një jelek, kurse në dimër sipër tij shtohej edhe një mintan me mëngë të gjata si dhe nje xhoke prej shajaku.
- ❖ Gjatësia, ngjyra dhe zbukurimi i xhokes ndryshonte veçanërisht nga pozita gjeografike apo zhvillimi i krahinave ku mbahej kjo veshje, duke krijuar kështu veçori të shumta lokale. K
- ❖ jo veshje qe e perhapur ne Mirdite, Diber, Mat, Shpat, Çermenike, Dumre, Myzeqe, Berat, Korçe, Kolonje, Gjirokaster, Sarande.



**VESHJE ME
FUSTAN TË GJATË
DHE ME
PËRPARJE**





VESHJA QYTETARE VLONJATE

Përbëhet nga një fustan i gjatë i derdhur një kapele me pare.

Përsipër gratë vishnin një sako të gjatë pothuaj deri tek kyçi i këmbës, prej kamoshi, shijakudhe e qëndisur me fije metalike të holla ngjyrë argjendi dhe fije të verdhë të cilët më parë janë përdredhur me njërin tjetrin.

Ngjyra e sakos, gjatësia dhe motivet zbukuruese ndryshonin sipas statusit social, pasurisë dhe moshës së gruas që e vishte.

Fustani gjithashtu në pjesën e gjoksit, tek mëngët dhe në fund të tij është i qëndisur me motive florelae dhe gjeometrike.

VESHJE VLONJATE



VARIANTE TË SAKOS







VESHJA VAJZAVE ÇAME

- ❖ Veshja me fustan të derdhur të gjatë deri në fund të këmbëve, me rudha ose pala të vogla, copa me të cilën ishte qepur fustani është terital, ose tafta.
- ❖ Fundi i tij, pjesa e gjoksit dhe e mëngëve ishte e zbukuruar me qëndisje. Vajzat në kokë mbanin dhe një shami trekëndëshe e cila ishte në anët e saj me trantell të hollë.
- ❖ Pjesë e veshjes ishte edhe një jelek i zi i shkurtër, që arinte poshtë gjoksit, i qëndisur me fije të trasha në ngjyrë të florinjte.
- ❖ Më sipër përcaktuam tipet e veshjeve të cilatishin pjesë e festivalit. Rruga deri në paraqitjen dinjitoze ishte e vështirë, problemet me veshjen ishin të shumta.

VESSHJE E VAJZAVE ÇAME



SHAMITË E KOKËS SË GRAVE





PËRFUNDIMET

U punua shumë me grupet folklorike që të ishin në nivelin e duhur. Lipset të bëhet më shumë punë për të pasur një prezantim sa më dinjitoz por edhe problemet me veshjen dhe jo vetëm të zgjidhen në mënyrë përfundimtare jo të përkohëshme.

Si pjesë e grupit të punës por edhe si punonjëse e DRKK Vlorë mendoj se zgjidhje e përherëshme e ruajtjes dhe transmetimit brez pas brezi të veshjes popullore është riprodhimi i disa varianteve të tipeve të veshjes të cilat hasen në Qarkun e Vlorës. Në ambientet e Muzeut Etnografik gjenden veshje të Rrethit të Vlorës të cilat rruhen në gjendje jo të mirë.

Shikohet me vend që këto veshje të riparohen, të konservohen dhe një komplet veshjeje për çdo variet të bëhet i ekspozueshëm, ndërsa kopmletet e tjera të bëhen të përdorshëm nga antarë të grupeve folklorike.

Një propozim tjetër është bashkëpunimi midis institucioneve siç janë DRKK Vlorë, IAKSA, Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë të bëjnë të mundur krijimin e një fondi të posaçëm me veshje popullore.

Fondi propozohet të krijohet në ambientet e dhe Këshillit të Qarkut Vlorë ose DRKK Vlore dhe një apo më shumë punonjës të specializuar të kujdeset për konservimin e tyre.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë se riprodhimet duhet të jenë sa më afër origjinalit në materialin e përdorur dhe ti qëndrojnë besnik atij në formën e prerjes, ngjyrat, motivet zbukuresë, bizhutë sipas statusit social dhe moshës.

Për të pasur një fond cilësor duhet me patjetër të bashkëpunohet me specialistët etnolog dhe fondin e veshjeve të IAKSA-së. mendoj se ky është një propozim me vlerë për cdo qark, pasi problem me veshjet nuk ka vetëm Vlora por të gjithë qytetet.

